



Funded by
the European Union



EU4Youth



Termet e Referencës ToRs

Pozicioni	Trajner/Ekspert për aktivitetin “Trajnim për kërkimin e punës dhe aftësitë e buta”
Vendi	Tiranë
Projekti	Projekti BE për Rininë EU4Youth “Hapi i radhës; Fuqizimi i të rinjve me aftësi të kufizuara drejt aftësive dhe mundësive për punësim”
Lloji i kontratës	Kontratë shërbimi
Nisja e shërbimit	Maj 2026
Ditët e shërbimit	16 ditë

Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA) është një organizatë jo qeveritare dhe jo fitimprurëse themeluar në vitin 2013 dhe punon në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus tek të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

DSA advokon për të drejtat dhe nevojat e individëve me sindromën Down në Shqipëri dhe ofron shërbime për fëmijet dhe të rriturit me sindromën Down, aftësi të tjera të kufizuara intelektuale dhe sfida në zhvillim. Fushat tona të ekspertizës përfshijnë; vlerësimin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve; hartimin e planeve individuale të ndërhyrjes terapeutike apo mbështetëse në qendër apo ambiente natyrale (shtëpi ose institucion arsimor), aplikimin dhe ndjekjen e këtyre planeve; mbështetje të prindërve përmes këshillimeve individuale dhe seancave në grup; trajnime me fokus kryesor tek mësuesit, psikologët, terapistë të gjuhës dhe të folurit, punonjës sociale dhe të tjerë profesionistë që punojnë me individë me aftësi të kufizuara; botimin e udhërrëfyesëve praktikë për punën profesionale në fushën e aftësisë së kufizuar; konceptimin dhe zbatimin e fushatave advokuese, ndërgjegjësuese si dhe të fushatave për mbledhje fondesh; organizimin e konferencave dhe tryezave të rrumbullakta me fokus aftësinë e kufizuar.

Qëllimi i projektit:

Projekti synon të nxisë përfshirjen sociale dhe ekonomike të të rinjve NEET me aftësi të kufizuara në Tiranë, përmes zhvillimit të qasjeve gjithëpërfshirëse të angazhimit në komunitet dhe forcimit të aftësive të tyre për punësim dhe vetëpunësim.

Në Tiranë, një numër i konsiderueshëm i të rinjve me aftësi të kufizuara që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim (NEET) përballen me barriera të shumta, përfshirë mungesën e aksesit në shërbime, nivelin e ulët të informimit, stigmatizimin dhe mungesën e mbështetjes së



Funded by
the European Union



EU4Youth

unicef
for every child



koordinuar. Si rezultat, ata dhe familjet e tyre shpesh ndihen të përjashtuar dhe pa mbështetjen e duhur për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme.

Ky projekt adreson këto sfida përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar nga individi, duke synuar të identifikojë, angazhojë dhe fuqizojë të rinjtë NEET me aftësi të kufizuara, si dhe të përfshijë aktivisht familjet e tyre në këtë proces.

Në kuadër të projektit, ky aktivitet synon të pajisë pjesëmarrësit me njohuri praktike në marketingun digjital dhe sipërmarrjen, duke i fuqizuar ata për të pasur akses në mundësi punësimi ose për të zhvilluar iniciativa të vetëpunësimit.

Në këtë kontekst, trajneri/ja do të jetë përgjegjës/e për planifikimin dhe zhvillimin e sesioneve të trajnimit, të organizuara në katër grupe me nga 10 persona me aftësi të kufizuara. Çdo cikël trajnimi do të zgjasë tre ditë, me seanca ditore nga 6 orë secila.

Përgjegjësitë e Trajnerit

Trajneri do të jetë përgjegjës:

- Të përshtasë kurrikulën e trajnimit në përputhje me nevojat e të rinjve me aftësi të kufizuara (NEET) dhe objektivat e projektit
- Të përgatisë planin e detajuar të sesioneve (agjendë ditore, metoda, materiale mbështetëse)
- Të zhvillojë sesionet e trajnimit në mënyrë ndërvepruese, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për të gjithë pjesëmarrësit
- Të sigurojë që përmbajtja të jetë e kuptueshme dhe e përshtatur sipas niveleve dhe aftësive të pjesëmarrësve
- Të bashkëpunojë ngushtë me lehtësuesin për të garantuar një mjedis mbështetës gjatë gjithë procesit të trajnimit
- Të përgatisë raporte pas çdo cikli trajnimi mbi ecurinë, sfidat dhe rekomandimet

Afatet kohore

Trajnimet do të ofrohen përgjatë muajit Maj – Shtator 2026

Kualifikimet/Kriteret:

Eksperti duhet të përmbushë kërkesat si më poshtë:

Kërkesa të detyrueshme

- Diplomë universitare në shkencë sociale, edukim, burime njerëzore ose fusha të ngjashme
- Minimumi 3 vite përvojë profesionale në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve në fushën e punësimit, kërkimit të punës dhe/ose aftësive të buta (soft skills)
- Përvojë e provuar në punë me të rinjtë, veçanërisht me personat me aftësi të kufizuara



Funded by
the European Union



EU4Youth

unicef
for every child



- Njohuri dhe përvojë në aplikimin e metodologjive gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për persona me aftësi të kufizuara
- Aftësi për të përshtatur përmbajtjen e trajnimit sipas nevojave dhe niveleve të pjesëmarrësve
- Përvojë në hartimin dhe përdorimin e materialeve trajnuese
- Integritet profesional, ndjeshmëri sociale dhe respekt për parimet e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- CV të përditësuar
- Diplomë të nivelit të studimeve
- Ofertën financiare (duke përfshirë TVSH apo taksa) për ditë pune (16 ditë pune, duke përfshirë dhe përgatitjen e materialeve të trajnimit dhe raportin përfundimtar)

Procesi i vlerësimit:

Fondacioni Down Syndrome Albania zotohet se do të zbatojë një proces të drejtë përzgjedhjeje duke konsideruar si kualifikimin teknik të ekspertëve ashtu edhe propozimet e tyre financiare. Kontrata do t'i jepet kandidatit, oferta e të cilit duhet të përmbushi kërkesat si më poshtë:

- Konsiderohet teknikisht në përputhje/e pranueshme me kriteret e vendosura më lart (vetëm aplikimet/ kandidatët teknikisht të përgjegjshëm do të merren parasysh për vlerësimin financiar)
- Dhe ka marrë rezultatet më të larta të kombinuara teknike dhe financiare.

Kriteret Teknike - 70% e vlerësimit total - pikë maksimale: 70

Kriteri A: Përputhshmëria e formimit akademik- 40

Kriteri B: Eksperiencë të mëparshme: 30

Kriteret Financiare - 30% e vlerësimit total – pikë maksimale: 30

Kandidatët që kanë marrë një minimum prej 70% (49 pikë) të pikëve maksimale të arritshme për kriteret teknike (70 pikë) do të konsiderohen për vlerësimin financiar.

Kandidatët janë të lutur të dërgojnë dokumentet e mëposhtme në adresat elektronike (to): info@dsalbania.org dhe cc:e.skura@dsalbania.org; me subjekt/titull e-maili: “Ofertë ekspert Trajnim për kërkimin e punës dhe aftësitë e buta për të Rinjtë NEET me Aftësi të Kufizuara” deri me datë 18 Maj 2026.